



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

V E N D I M

Nr. 606, datë 16.10.2024

PËR

PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR NR. 3/2022 TË FILLUAR NDAJ ISH MAGJISTRATIT {...}, PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 16.10.2024, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore, aktet e procedimit disiplinor nr. 3/2022 që i përket :

KËRKUES:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, përfaqësuar me autorizim nga z. {...}.

SUBJEKT I PROCEDIMIT: Magjistrati {...},

OBJEKTI I KËRKESËS:

1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.

2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore :

- “Pezullim nga detyra”, për një periudhë deri në dy vjet;

BAZA LIGJORE:

Neni 138; neni 101, pika 1, shkronja “b”; neni 102, pika 1, shkronja “dh”; neni 110 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në seancë dëgjimore, pas shqyrtimit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 142 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi propozimin e relatorit z. Ridvan Hado, për përfundimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...} pa një vendim përfundimtar, Këshilli

V Ë R E N:

I. TË DHËNA MBI FILLIMIN E PROCEDIMIT DISIPLINOR

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 2740/29 prot., datë 23.11.2022 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës¹.

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 138 të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 101, pika 1, shkronja “b”, neni 102, pika 1, shkronja “dh” i Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” e këtij ligji.

3. Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore “Pezullim nga detyra”, për një periudhë deri në dy vjet, të parashikuar nga neni 110 i Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar në vijim si Ligji për Statusin).

4. Me vendimin nr. 518, datë 01.12.2022, pas hedhjes së shortit, Këshilli ka vendosur si relator të çështjes, z. Ridvan Hado, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Disiplinor.

5. Në vijim, me vendimin nr. 519, datë 06.12.2022, Këshilli ka vendosur kalimin e çështjes në seancë dëgjimore, duke caktuar datën 22 Dhjetor 2022, ora 10:00, si datë të zhvillimit të seancës dëgjimore, për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, duke njoftuar rregullisht palët në zbatim të parashikimeve të nenit 138 të Ligjit për Statusin. Bashkë me njoftimin për caktimin e seancës dëgjimore, magjistratit i janë njoftuar dhe të drejtat e tij gjatë procedimit disiplinor, si dhe i është caktuar një afat për të paraqitur një parashtresë me shkrim, sipas përcaktimeve të nenit 141, pika 2, gërma a) të ligjit.

6. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, në seancë dëgjimore ka rezultuar se magjistrati nuk është paraqitur asnjëherë përpara Këshillit, duke depozituar raporte mjekësore si arsye për shtyrjen e seancave.

¹ Depozituar në Këshillin e Lartë Gjyqësor me nr. 5135/4 prot., datë 24.11.2022.

6.1 Pas shqyrtimit të akteve mjekësore/raporteve të depozituara nga magjistrati, bazuar në diagnozën e shënuar në këto akte, Këshilli me vendimin nr. 223, datë 08.05.2023, ka vendosur :

1. *Fillimin e procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës.*
2. *Të ngarkojë Komisionin e Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për efekt të kësaj procedure.*

7. Ndërkohë, referuar vendimmarrjes së mësipërme, Këshilli pas shqyrtimit të aktit mjekësor, vërtetim datë 13.07.2023 lëshuar nga KMCAP i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër bazuar në vendimin nr. 452 datë 13.07.2023, të depozituar nga subjekti i procedimit në rrugë elektronike, mbështetur në nenin nenin 116 pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 44 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr. 436 datë 19.07.2023 ka vendosur :

1. *Pezullimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj magjistratit {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për një periudhë kohe 1 (një) vit.*
2. *Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjektit të procedimit disiplinor, magjistratit z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

8. Këshilli, në zbatim të vendimit të tij nr. 223, datë 08.05.2023, pas shqyrtimit të vendimit të KMCAP, i cili përcakton se z. {...} plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë, nga data 19.06.2023-30.06.2024, pasi vuan nga një sëmundje...dhe është i paafte për punë,...” ka konkluduar se procedura e verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...} në kuadrin e aftësisë/paafhtësisë për punë e cila do të zhvillohej nga Këshilli është zgjidhur nga KMCAP-i (Komisioni Mjekësor i caktimit të Aftësisë për Punë) me vendimin nr. 452, datë 13.07.2023 dhe si e tillë kjo procedurë e nisur nga Këshilli ka mbetur pa objekt. Në këto kushte, Këshilli me vendimin nr. 664 datë 02.11.2023 ka vendosur :

1. *Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të procedurës së verifikimit të mundësisë fizike dhe mendore për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit nga z. {...}.*
2. *Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar.*

9. Sa sipër, në kushtet kur tashmë shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 436 datë 19.07.2023 për “Pezullimin e procedimit disiplinor 3/2022 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”, kishte rënë dhe nuk ekzistonte më, duhet të shfuqizohej vendimi i pezullimit.

9.1 Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 67 të tij parashikon lidhur me vendimet e ndërmjetme se : “1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme: a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar; b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm; c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj. 2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak i parashikuar në pikën 1, të nenit 67, të këtij Kodi”.

10. Ndërkohë, magjistrati z. {...}, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë², i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*. Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 692 datë 29.07.2023, ka vendosur:

1. *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.....*

11. Subjekti i procedimit disiplinor z. {...}, ka ushtruar të drejtën e ankimit para Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndaj vendimit të mësipërm të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

11.1 Në vijim, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka njoftuar Këshillin e Lartë Gjyqësor se në përfundim të gjykimit në dhomë këshillimi, trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë unanime, me vendimin nr. 256 datë 29.07.2024³ ka vendosur :

– *Lënien në fuqi të vendimit nr. 692, datë 28.07.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit {...}*.

– *Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*

12. Pas njohjes me këto rrethana faktike dhe ligjore, në kushtet kur shkak i pezullimit të procedimit disiplinor, konsideruar nga Këshilli, në vendimin e tij nr. 436 datë 19.07.2023 për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës” kishte rënë dhe nuk ekzistonte më, Komisioni Disiplinor në mbledhjen e datës 10.09.2024 vendosi t’i parashtojë Mbledhjes Plenare projekt vendimin për Shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor 3/2022 të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

² “3. Të gjithë gjyqtarët, ... i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”.

³ <https://kpa.al/njoftim-vendimi-256/>

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 523 datë 24.09.2024 ka vendosur :

1. *Shfuqizimin e vendimit nr. 436 datë 19.07.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.*
2. *Vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe caktimin e seancës dëgjimore me datë 16.10.2024, ora 11.*

II. VLERËSIMI PËR VIJIMIN E SHQYRTIMIT TË PROCEDIMIT DISIPLINOR

14. Nga Këshilli në seancën dëgjimore të datës 16.10.2024, u kërkua qëndrimi i palëve në proces lidhur me vijimin e shqyrtimit të procedimit disiplinor.

14.1 Përfaqësuesi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, referuar situatës ligjore aktuale, i kërkoi Këshillit të Lartë Gjyqësor, të vendosë përfundimin e procedimit disiplinor ndaj ish magjistratit {...}, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 101, pika 1, shkronja “b”, neni 102, pika 1, shkronja “dh” i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pa një vendim përfundimtar.

14.2 Ndërsa ish magjistrati z. {...}, nuk u paraqit në seancë dëgjimore, ndonëse kishte dijeni rregullisht për zhvillimin e saj.

15. Lidhur me vijimin e shqyrtimit të çështjes, rezulton se me marrjen formë të prerë të vendimit nr. 692 datë 29.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. {...} ka humbur statusin e magjistratit, duke mos ushtruar më këtë funksion.

16. Procesi i rivlerësimit kalimtar dhe procedimi disiplinor sipas Ligjit për Statusin, janë dy procese të pavarura nga njëri tjetri, që zhvillohen nga organe të ndryshme, të pavarura dhe sipas procedurave jo të njëjta, rrethana këto që, pavarësisht faktit që ato zhvillohen ndaj të njëjtit magjistrat, bëjnë të pamundur bashkimin e tyre në një procedim të vetëm. Ndërkohë këto procese kanë ndikim ndaj njëri tjetrit, duke përcaktuar vijueshmërinë e tyre. Kështu, procesi i rivlerësimit, që është një proces i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët në detyrë (në momentin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016), përcakton vijimin e gëzimit nga ata të statusit të magjistratit sipas Ligjit për Statusin. Nga ana tjetër, moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit passjell mbarimin e menjëhershëm të statusit të magjistratit, rrethanë kjo që përbën shkak për

mbylljen e procedimit disiplinor sipas Ligjit për Statusin, referuar nenit 139, pika 1, shkronja “c”⁴ në lidhje me nenin 134, pika 1, shkronja “ç”⁵, nenin 64, pika 1, shkronja “ç”⁶ dhe nenin 164, të tij.

17. Neni 164 i Ligjit për Statusin, në dispozitat e tij kalimtare, përcakton se: “1. Gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar në këtë ligj vetëm nëse: ...b) kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit, në përputhje me ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.”

18. Neni 179/b, pika 7, e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar se :“7. Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. ...”.

19. Neni 139, pika 1, shkronja c, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse:c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”;..”.

20. Neni 134, pika 1, shkronja ç, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji ose nuk ushtron funksionin e tij në mënyrë të përhershme, sipas parashikimeve të nenit 67 të këtij ligji;..”.

21. Neni 64, pika 1, shkronja ç, i Ligjit për Statusin, përcakton se: “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji;..”.

22. Në kushtet kur z. {...} nuk e gëzon më statusin e magjistratit, nuk është objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, referuar neneve 147 dhe 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilave Këshilli është autoriteti shtetëror që siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, ku vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

⁴ “1. Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: ...; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d”; ...”.

⁵ “1. Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbyll hetimin, nëse provohet se pretendimet janë të pabazuara ose provat e mbledhura dhe rezultatet e hetimit të çojnë drejt përfundimit se: ...; ç) magjistratit i mbaron statusi, bazuar në kriteret e parashikuara, në shkronjat “b” deri në “ç”, të pikës 1, të nenit 64, të këtij ligji...”.

⁶ “1. Statusi i magjistratit mbaron në rastet kur: ...; ç) shkarkohet nga funksioni për përgjegjësi disiplinore, sipas parashikimeve të këtij ligji; ...”.

23. Në vijim, referuar nenit 95 të K.Pr.Administrative - Pamundësia në objekt apo qëllim - i cili shprehet se : *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*, shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, duhet ndërprerë/mbyllur pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

III. KONKLUZIONI

24. Bazuar sa sipër, në kushtet kur z. {...} nuk e gëzon më statusin e magjistratit, nuk mund të jetë më objekt i veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor, për rrjedhojë shqyrtimi i procedimit disiplinor të filluar ndaj tij, duhet ndërprerë pa një vendim përfundimtar për shkak se objekti apo qëllimi për të cilin kishte nisur është bërë i pamundur.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 147, 147/a, 179/b, pika 7, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 64, 134, 139 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 97, 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor

V E N D O S I :

1. Përfundimin e procedimit disiplinor nr. 3/2022 të filluar ndaj ish magjistratit z. {...}, pa një vendim përfundimtar.
2. Një kopje e vendimit t’i njoftohet z. {...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR